



Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.1 , 3.4 , 15.1 pikat (a), (c), (e), (f), (j) dhe 21.2, 75, 76, 77, 79, 80 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të miratimit të dispozitave përkatëse mbi rregullat e ajrit të bazuara në Standardet dhe Praktikrat e Rekomanduara të përcaktuara në Aneksin 2 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, 1944, dhe për të harmonizuar aplikimin e klasifikimit të hapësirës ajrore sipas ONAC, me qëllim të garantimit dhe të ofrimit të shërbimeve të sigurta dhe efikase të trafikut ajror në territorin e Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 6 / 2013 MBI RREGULLAT NË AJËR

Neni 1

Fusha e zbatimit

1.1 Kjo Rregullore përcakton kërkesat për rregullat e fluturimit në përputhje me Standardet dhe Praktikrat e Rekomanduara (SPR) të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC), të përcaktuara në Shtojcën 2, Rregullat në ajër, në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, 1944.

1.2 Rregullat në ajër në Republikën e Kosovës përcaktohen sipas SPR-ve të Shtojcës 2 dhe Shtesave 1-5, Bashkëlidhjet A dhe B të botuara në amendamentin 43 të edicionit të 10-të, korrik 2005 nga ONAC.

Neni 2

Zbatimi i SPR-ve

2.1 Shtojca 2 për rregullat në ajër, siç është përcaktuar sipas nenit 1, paragrafi 2 të

kësaj rregulloreje do të zbatohet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2.2 SPR-të e zbatueshme të specifikuara në Shtojcën 2 të rregullave në ajër dhe shtesat dhe bashkëlidhjet e saj do të jenë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, përveç nëse dispozitat e nenit 4 të kësaj rregulloreje përcaktojnë ndryshe.

Neni 3

Shprehjet dhe përkufizimet

3.1 Për qëllim të kësaj rregulloreje shprehjet "Shtet Kontraktues" dhe "Shteti", të përdorura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose në njëjës apo në shumës në Shtojcën 2 në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, siç është përcaktuar më sipër në nenin 1, paragrafi 2, do të lexohen si "Republika e Kosovës".

3.2 Dallimet e paraqitura në nenin 4 të kësaj rregulloreje do të kenë kuptim në kontekstin e kësaj rregulloreje ose si largim nga standardi ose si ngritje e një praktike të rekomanduar në nivelin e një standardi.

Neni 4

Dallimet nga SPR-të

4.1 Nuk ka ndryshime të aplikueshme nga SPR-të e Shtojcës 2 në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, 1944, të përcaktuar sipas nenit 1, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje. Ky informacion do të publikohet në Publikimin Informativ Aeronautik (PIA), njëzet e tetë (28) ditë nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Disponueshmëria

Teksti i SPR-ve të Shtojcës 2, siç është përcaktuar në nenin 1, paragrafi 2, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje i është bashkëngjitur kësaj rregulloreje si Shtojca 1.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 10 janar 2014.

Prishtinë, 26 dhjetor 2013.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm